



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

Zyra e Kryetarit të Komunës

/Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje



Procesverbal nga mbledhja e VI- të e KKSB-së e mbajtur më 22 dhjetor (e hënë) 2025, në ora 10:00, në Sallën e vogël të Ndërtesës së Komunës.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Faruk Beqa (Nënkryetari i Komunës së Shtimes), Haxhi Behluli (Komandant i Policisë në Shtime), Osmon Zeqiraj (FSK), Muhamet Mehmeti (ZKKK) Lulzim Sahiti (DKA), , Albulenë Emini (DSHP), Bajram Gashi (NJPZSH), Vlora Hyseni (Z.I), Admire Selmani (Z.I), Teuta Mustafa (Z.I) .

Nënkryetari Faruk Beqa, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, prezantoi edhe pikat e rendit të ditës që janë:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.11.2025;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
3. Kontrolli, shpërndarja dhe ndalesat për mjetet piroteknike;
4. Raport nga QKMF "Dr. Vezir Bajrami", Shtime;
5. Të ndryshme.

Pasi të gjithë anëtarët u pajtuan që nga rendi i ditës të largohet pika e katërt për arsye të mospranisë në mbledhje të drejtorit të QKMF-së, nënkryetari Faruk Beqa hodhi në votim Ekstrakt-Procesverbalin e mbledhjes së kaluar, ku unanimitisht u aprovua nga të gjithë anëtarët. Më pas për pikën e dytë të rendit të ditës fjala iu dha komandantit të stacionit policer në Shtime, z. Haxhi Behlulit.

Haxhi Behluli: Faleminderit të gjithëve, më lejoni të ju përshëndes edhe një herë për këtë takim. Është mirë që takimi i radhës po mbahet dhe realizimi i këtyre takimeve na fuqizon edhe në sigurinë e përgjithshme në rajonin tonë. Po mundohem të shprehem sa më shkurt, megjithatë

po e paraqes raportin e 11 mujorit. Pasi që gati jemi edhe ne fund të vitit, unë do t'í paraqes disa statistika për 11 mujorin dhe mendoj që paraqitet më saktë niveli i sigurisë në rajonin tonë. Duke pasur parasysh që këtë raport të 11 mujorit të këtij viti, duke i përfshirë të gjitha rastet penale që kanë ndodhur dhe të gjitha incidentet vlerësohet që siguria është e kontrolluar, d.m.th nuk është jashtë kornizave, pra nuk kemi pasur ndonjë gjendje të jashtëzakonshme përveç situatës së kushteve atmosferike në muajin e kaluar. Por në përgjithësi mund të them që kjo situatë është e qetë, e mirë, e kontrolluar edhe prej mekanizmave të sigurisë dhe kjo gjendje e mirë vjen edhe prej bashkëpunimit. Këtu mbetet me i falënderu të gjitha institucionet e veçanërisht edhe qytetarët që falë vetëdijësimit të tyre nuk kemi pasur ndonjë gjendje që neve me na destabilizu. Kjo me gjithë faktin që asnjë vrasje nuk e kemi, nuk kemi rrëmbime, nuk kemi grabitje; raste këto që janë prej veprave penale më të rënda dhe dhe ndikojnë keq në shoqëri. Këto janë realisht tri prej veprave që fatmirësisht nuk kanë ndodhur dhe që si rezultat vlerësojmë që e kemi një situatë të qetë. Po të krahasojmë 11 mujorin e vitit të kaluar me 11 mujorin e këtij viti kemi ngritje te rasteve nga 387 në 405. Nga këto 405 raste, 127 janë regjistruar si aksidente në trafikun rrugor me dëme materiale dhe me të lënduar, por pa fatalitet. Shumica prej rasteve janë dërgu në prokurori, janë trajtu dhe janë zbulu shumica prej kryesve të veprave, dhe kjo drejtpërdrejt na ka ndihmuar që të kemi një siguri më të mirë. Këto vepra që ndërlihen me sigurinë e përgjithshme si vepra të ndishme kundër jetës, pasurisë, familjes janë paraqitur në stacionin policor në Shtime, dhe për më tepër i shihni në tabelën në vijim:

Veprat penale	Janar – Nëntor 2024	Janar – Nëntor 2025
Vrasje	00	00
Rrëmbim	00	00
Vrasje në tentativë	00	01 person i plagosur
Grabitje	00	00
Vjedhje	25	32
Vjedhje e rëndë	30	25
Kanosje	26	38
Sulm	13	21
Lëndim i lehtë trupor	27	38
Lëndim i rëndë trupor	04	02
Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	05	07

Armëmbajtje pa leje	18	22
Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm	03	03
Falsifikim i parasë	14	10
Dhunë në familje	23	30
Sulm seksual	01	02
Ngacmim	08	08
Detyrim	01	01
Shantazh	00	02
Pengim i personit zyrtar në detyrë zyrtare	01	02
Sulm ndaj personit zyrtar	04	00
Mashtrim	07	05
Zjarrvënie	00	03
Gjueti e kundërligjshme	01	01
Rrezikim në vendin e punës	05	02 (1 humbje jete)
Vjedhje e pyllit	03	02
Ndotje, degradim i ambientit	03	01
Posedimi i paautorizuar i narkotikëve	05	07

Një rast i vrasjes në tentativë që ka qenë gjatë këtij viti, e kemi pasur pra një person të plagosur, vlen të ceket që personi që e ka kryer këtë akt ka qenë me dosje kriminale dhe muajin e kaluar është arrestuar nga njësitë e stacionit të Shtimes dhe është dërgu në paraburgim dhe për të janë duke vazhduar hetimet. Sa i përket fenomenit të kanosjeve, më shumë kanë ndodhur kryesisht përmes rrjeteve sociale. Te dhuna në familje kemi ngritje të rasteve, por një punë e mirë që është bërë në këtë drejtim është pasi të gjitha janë trajtuar shpejt nga gjykata dhe prokuroria. Prej tyre kemi pasur edhe urdhër-mbrojtje që janë përcjellë prej policisë dhe viktimat kanë qenë në mbrojtje të policisë çdo herë.

Në pika të shkurtra, veprimet policore, angazhimet dhe aktivitetet që ndërliken për ngritjen e nivelit të sigurisë:

- Hetimi dhe zbulimi i disa rasteve që ndërlidhen me disa vepra penale ka pasur rezultat në zbulimin e disa rasteve të vjedhjeve në markete, shtëpi, shkolla, poashtu janë parandaluar grupe kriminale për vjedhjen e kafshëve;
- Është duke u punuar me njësi relevante për parandalimin e drogave, sigurisë në shkolla, lokale të kafiterive etj, dhe janë kryer kontrolla në disa lokale në Shtime ku janë bastisur rreth 100 persona;
- Gjatë trajtimit dhe hetimit të rasteve janë arrestuar persona me rrezikshmëri të cilët kanë qenë edhe recidivist të drogave, dhunës në familje, që është ndërlidhur me rastin vrasje në tentativë, kanosjeve, armëmbajtjes (këta persona janë dërguar në prokurori, gjykatë dhe janë vendosur në burg);
- Është duke u zbatuar plani operativ “Rrjeta” dhe në këtë plan janë angazhuar të gjitha njësitë, hetimet janë duke vepruar gjatë orëve të mbrëmjes, po ashtu njësitë speciale vepronë me kontrolla të herëpashershme në rajonin tonë.

Për sigurinë në komunikacion është punuar dhe vazhdimisht kemi plane në këtë drejtim. Gjatë këtij 11 mujori janë shqiptuar 3291 gjoba, më shumë ka për shpejtësi, për parkingje të parregullta në qytet, për mos regjistrim të veturave, etj. Të gjitha këto u mundova që në poika të shkurtra t’i paraqes para jush, por nëse ka dikush ndonjë pyetje tjera jam i hapur për përgjigje.

Unë i kam edhe disa rekomandime për përmirësimin e gjendjes së sigurisë:

- Stabilizimi, shtimi i kamerave të sigurisë (rregullimi dhe përmirësimi i kamerave ekzistuese), pastaj vendosja e kamerave në fshatra dhe disa pika me rëndësi për sigurinë.
- Të sigurohen vende për parkingje të veturave, vendosja e disa shenjave të trafikut sipas nevojës
- Planifikimet për vitin që vjen për izolimin apo strehimin e qenve endacakë
- Të ndryshohet gjendja e oborrit të shkollave fillore për sigurinë e nxënësve të vegjël
- Të monitorohet transporti i fëmijëve, të licensohen kombibusët

- Të ketë kontrollë të lokaleve ushqimore, kafiterive, kioskave; inspektimi i tyre për gjendjen e artikujve, pastërtisë dhe lejeve përkatëse për të zhvilluar veprimtarinë
- Koordinimi dhe bashkëpunimi institucional në rastet kur kemi të bëjmë me persona me probleme familjare, psiqike dhe shëndetësore
- Ngritja e nivelit të sigurisë në shkolla nga drejtoritë, mësimdhënësit dhe sigurimi i objekteve shkollore.

Komandanti Behluli theksoi se afër shkollës fillore të ulët “Emin Duraku” ka nevojë të bëhet një rrethrotullim apo ndonjë zgjidhje tjetër në mënyrë që të lehtësohet trafiku në kohën kur prindërit i sjellin dhe i marrin fëmijët nga shkolla, pasi përveç tollovisë po krijohet gjithashtu rrezik si për automjetet ashtu edhe për këmbësorët, prindër dhe nxënës. Ai rikujtoi poashtu se pranë shkollës ka çdo herë një patrullë policie e cila mban rendin në trafik dhe ndikon në uljen e rrezikut. Poashtu, njoftoi se tashmë policia ka një veturë me mbishkrimin “Policia e Lagjes”, dhe policët e kësaj patrulle mirren edhe me problemet në shkolla, por u ankua se ka ankesa për nxënësit problematikë të moshës së vogël nën 10 vjeç nga mësimdhënësit pa u konsultuar me drejtorin. Meqenëse ligji nuk e lejon që të veprohet në këtë drejtim, rekomandoi që mësimdhënësit bashkë me drejtorinë e shkollës dhe me Qendrën për Punë Sociale të mirret me këto raste. Gjithashtu u cek edhe se policia është e përgatitur për periudhën e fundvitit ku dihet që shtohet edhe fluksi i qytetarëve që vijnë nga diaspora për festat e fundvitit, duke shtuar gjithashtu faktin që në javën e fundit të vitit janë edhe zgjedhjet e parakohshme në nivel qendror.

Nënkryetari Beqa falënderoi komandantin e policisë për bashkëpunimin dhe informatat e detajuara. lidhur me çështjet që u trajtuan në pikën e pare dhe gjithashtu meqë kohëve të fundit një person ka shkaktuar disa probleme dhe ka nevojë për trajtim të shëndetit mendor, nënkryetari rekomandoi që të bëhet një shkresë dhe të trajtohet personi në fjalë. Më tej, fjalën e mori z. Lulzim Sahiti i cili shprehu shqetësimin e tij që tek hyrja te shkolla Emin Duraku parkohen veturat e qytetarëve dhe të mësimdhënësve dhe nuk mirren masa, sepse në rast të ndonjë emergjence dera mbetet e vështirë për tu kaluar. Sa i përket rrethrotullimit afër SHMU “Emin Duraku” z.Sahiti tha që me sa ka informacion një projekt do të bëhet tek hyrja, por nga një anë tjetër.

Sa i përket çështjes së parkimit para dyerve të shkollës, z. Behluli tha që ka presion të vazhdueshëm ndaj policëve që të mbikqyret ajo pjesë, por duhet edhe që shkolla të kryejë punën

e saj, të bëjë parkingjet e veta. Z. Sahiti u përgjigj që nuk është obligim i institucionit të shkollës që të sigurojë vendparkingje për mësimdhënësit dhe që askush nuk ka të drejtë që të bllokojë hyrjen e shkollës.

Faruk Beqa: Jemi të vetëdijshëm për problemet që shkaktohen nga qarkullimi në mëngjes kur nxënësit dhe mësimdhënësit shkojnë në shkollë, dhe që aty s'ka vend ku të parkohen. Neve na ka dalë në ndihmë policia me një patrullë që del çdo mëngjes aty dhe e rregullon komunikacionin. Çfarë ne planifikojmë të bëjmë aty janë mundësitë që te stacioni i vjetër i policisë, te salla e sporteve, të krijohet hapësirë që prindërit të parkohen aty derisa t'i lënë fëmijët në shkollë në mënyrë që të mos pengohet komunikacioni.

Lulzim Sahiti: Është mundësia që aty ku është parking të ngushtohet trotuari, dhe një vendparkim të jetë për të gjithë qytetarët, përndryshe në oborr nuk mund të hynë sepse është rrezik permanent për fëmijë.

Faruk Beqa: Kjo që ne po diskutojmë është mirë që të shkojë si rekomandim për Drejtorinë e Urbanizmit, sepse ne s'kemi të drejtë të marrim vendime të prera, që të bëjë një zgjidhje në bashkëpunim me drejtorinë e arsimit dhe drejtorinë e shkollës.

Në pikën e tretë të ditës në lidhje me kontrolli, shpërndarjen dhe ndalesat për mjetet piroteknike fjalën e mori zyrtarja e Drejtorisë për Shërbime publike Albulena Emini.

Albulena Emini: Faleminderit për fjalën nënkryetar, atëherë në emër të Drejtorisë për Shërbime Publike, konkretisht drejtorit të drejtorisë Bardhyl Rushiti, jam këtu para jush për t'ju informuar në lidhje me shpërndarjen apo mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike. Sa kam informacion, javën e kaluar, edhe kryetari ynë si t'gjithë kryetarët e komunave të tjera ka marrë vendim për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike, apo përdorimi i kontrolluar i tyre. Në këtë rast, ne si DSHP e kemi obligim, meqë në të kaluarën kemi qenë si sektor i inspektoratit në kuadër të drejtorisë së shërbimeve publike, tash meqë jemi të shpërndarë po e marr prapë përsipër në këtë rast që ne do të jemi në terren vazhdimisht edhe po e bëjmë kontrollin e shitjes së këtyre mjeteve piroteknike. Domethënë mos të kemi shitës ambulante, po të gjithë ata të cilët provojmë ta bëjnë shpërndarjen e këtyre mjeteve shpërthyesë të jenë të pajisur me pëlqim nga DSHP, dhe marrë parasysh që këto paraqesin edhe ndotje mjedisore të jetë një përdorim i kontrolluar, sidomos në natën festive, por jo edhe ditëve të tjera. Kështu që unë nuk kam diçka tjetër me shtu, ne do të jemi në terren nga sot, do të bëjmë një kontrollë më rigoroze.

Z. Sahiti shtoi që vendimi për ndalim është i mangët pasi lokalet lejohet të shesin, por klientët që i blejnë një pjesë janë edhe fëmijë dhe për këtë vepër nuk mund të dënohen. “Unë mendoj që lokalet afariste duhet të mbajnë përgjegjësi për shitje dhe sipas nevojës të dënohen”.

Albulena Emini: Realisht nuk ka të bëjë me biznese. Bizneset duhet të kenë një dokumentacion për prejardhjen e mjeteve që ata i shesin, në këtë rast është inspektori i tregut që do të kontrollojë dokumentacionin. Nëse ka shitës që shitjen e bëjnë në hapësira të hapura ata do të obligohen të pajisen me pëlqim nga drejtoria për shërbime publike. Unë pajtohem me juve që nuk mund të dënohet fëmija por shitësi, dhe në këto raste nuk duhet të reagojë vetëm inspektorati, por edhe policia.

Bajram Gashi: Unë vec deshta me u ndërlidh te ky vendimi i kryetarit që është urdhëresë mungon kodi sepse nëse ndodh që ndonjë qytetar të humb ndonjë gjymtyrë, aty tani linden telashe.

Faruk Beqa: Atëherë me disa konkluzë u morëm vesh që KKSB-ja me nxjerr një pëlqim apo rekomandim për rastin e personit që po shkakton shqetësime te qytetarët e që tash qenka në paraburgim dhe u fol për masat e shtuara për fundvit nga policia dhe nga të gjithë akterët e tjerë që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve unë po e llogaris të përmbyllur këtë takim. Faleminderit!

Mbledhja përfundoi në ora 10:50

Procesmbajtës:
Vlorë Hyseni



Lista e pjesëmarrësve në mbledhjen e VI-të të KKSB

Shtime, 22 dhjetor 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1.	ALBULENË EMINI	K. SHITIME	
2.	Osmom Zegonaj	FSK	
3.	HAXHI BEHZULI	PAUQA E TOSOR	
4.	FARUK BEGA	K SHITIME	
5.	Bajram Gjezuli	AME/NDPESH	
6.	Muhamet Mehmeti	ZKKK	
7.	Julzim Sahiti	DKA-Shtime	
8.	Admir Selmani	Zyra Informimit	
9.	Tenta Mustafa	Zyra e Informimit	T. Mustafa
10.	Vlora Zyreni	Zyra për Informim	
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			